



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 15.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës: 13.05.2023, të parashtruar nga OE ProDif SH.P.K., adresa- Prishtinë, Matiqan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e teknologjisë informative - Ritenderim" me nr. të Prokurimit: 613-23-4401-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

I Hudhet poshtë si e jashtë afatshme, kërkesa për ri-shqyrtim, e paraqitur me dt: 13.05.2023, nga OE ProDif SH.P.K., adresa- Prishtinë, Matiqan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e teknologjisë informative - Ritenderim" me nr. të Prokurimit: 613-23-4401-2-2-1.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka filluar procedurat e prokurimit për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e teknologjisë informative - Ritenderim" me nr. të Prokurimit: 613-23-4401-2-2-1. AK ka pranuar kërkesë për Ri-shqyrtim nga OE ProDif SH.P.K., adresa- Prishtinë, Matiqan me dt: 13.05.2023, ndersa hapja është paraparë për dt: 15.05.2023.

Duke u bazuar në RREGULLOREN, Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, rrespektivisht Neni 60, paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore, paragrafi 60.1, lidhur me piken a) të kësaj rregullore, kërkesa për Rishqyrtim Hudhet poshtë si e jashtë afatshme.

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtor i Prokurimit